



VENDIM
Nr. 550, datë 27.8.2014

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR
MBROJTJEN E SIGURISË DHE
SHËNDETIT TË PUNËMARRËSVE NGA
RISQET E LIDHURA ME EKSPOZIMIN
NDAJ AGJENTËVE BIOLOGJIKË NË
PUNË”¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 39, të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve nga risqet e lidhura me ekspozimin ndaj agjentëve biologjikë në punë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen të gjitha ministratë dhe institucionet në varësi të tyre për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RREGULLORJA
**PËR MBROJTJEN E PUNËMARRËSVE NGA
RISQET E LIDHURA ME AGJENTËT
BIOLOGJIKË NË PUNË**

SEKSIONI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve nëpërmjet parandalimit të risqeve, që janë të pranishme ose që mund të krijohen nga ekspozimi ndaj agjentëve biologjikë në punë.

2. Kjo rregullore zbatohet në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon përdorimin e

kontrolluar të mikroorganizmave të modifikuar gjenetikut dhe lëshimin e tyre të vullnetshëm në mjedis.

Neni 2
Përkufizime

1. Për qëllim të kësaj rregulloreje, termat e përdorur kanë kuptimet e mëposhtme:

a) “agjent biologjik” nënkupton mikroorganizmat, përfshirë ata që janë modifikuar gjenetikut, kulturat qelizore dhe endoparazitët njerëzorë, që mund të jenë në gjendje të provokojnë çfarëdolloj infeksioni, alergjie ose toksiciteti;

b) “mikroorganizëm” nënkupton një njësi mikrobiologjike, qelizore ose joqelizore, të aftë të riprodhohet ose të transferojë material gjenetik;

c) “kulturë qelizore” nënkupton rritjen *in-vitro* të qelizave që rrjedhin nga organizma shumëqelizorë;

ç) “vlerësim i riskut” është vlerësimi i riskut të ekspozimit ndaj agjentëve biologjikë në përputhje me nenin 3, pika 3 të kësaj rregulloreje.

2. Agjentët biologjikë klasifikohen në katër grupe risku, në përputhje me nivelin e tyre të riskut për infektim:

a) “agjent biologjik i grupit 1” nënkupton një agjent biologjik, që nuk ka të ngjarë të shkaktojë sëmundje te njerëzit;

b) “agjent biologjik i grupit 2” nënkupton një agjent biologjik, që:

- mund të shkaktojë sëmundje te njerëzit dhe mund të jetë një rrezik për punëmarrësit;

- nuk ka të ngjarë që të përhapet në komunitet; dhe

- zakonisht janë të disponueshme profilaksi ose trajtime të efektshme.

c) “agjent biologjik i grupit 3” nënkupton një agjent biologjik që:

- mund të shkaktojë sëmundje të rënda te njerëzit dhe paraqet një rrezik serioz për punëmarrësit;

- mund të paraqesë një risk për përhapje në komunitet; dhe

- zakonisht janë të disponueshme profilaksi ose trajtime të efektshme.

ç) “agjent biologjik i grupit 4” nënkupton një agjent biologjik, që:

- shkakton sëmundje të rëndë te njerëzit dhe është një rrezik serioz për punëmarrësit;

- mund të paraqesë një risk të lartë për përhapje në komunitet; dhe

- zakonisht nuk janë të disponueshme profilaksi ose trajtime të efektshme.

1. Direktiva e BE-së 98/24 KE, e datës 7 prill 1998, për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së punëmarrësve nga risqet e lidhura me ekspozimin ndaj agjentëve biologjikë në punë (direktiva e shtatë individuale në kuptim të nenit 16(1) të direktivës 89/391/KEE) (Celex 32000L0054).



3. “Autoritet kompetent” në kuptimin e kësaj rregulloreje, është ministria përgjegjëse për shëndetësinë.

Neni 3

Fusha e zbatimit, përcaktimi dhe vlerësimi i risqeve

1. Kjo rregullore zbatohet për veprimtaritë, në të cilat punëmarrësit janë ose mund të ekspozohen ndaj agentëve biologjikë gjatë punës së tyre.

2. Në rastin e një veprimtarie që mund të përfshijë një risk për ekspozim ndaj agentëve biologjikë, punëdhënësi duhet të përcaktojë natyrën, shkallën dhe kohëzgjatjen e ekspozimit të punëmarrësve, në mënyrë që të jetë në gjendje të vlerësojë çdo risk për shëndetin ose sigurinë e punëmarrësve, si dhe të përcaktojë masat që duhen marrë.

Në rastin e veprimtarive që përfshijnë ekspozimin ndaj disa grupeve të ndryshme të agentëve biologjikë, punëdhënësi vlerëson riskun mbi bazën e rreziqeve të paraqitur nga të gjithë agentët biologjikë të rrezikshëm të pranishëm.

Punëdhënësi rivlerëson rregullisht riskun një herë në vit dhe në çdo rast kur ndodh një ndryshim në kushtet që mund të ndikojnë mbi ekspozimin e punëmarrësve ndaj agentëve biologjikë.

Punëdhënësi duhet të vërë në dispozicion të autoriteteve të inspektimit dhe autoriteteve kompetente me kërkesë të tyre, informacionin e përdorur për kryerjen e vlerësimit.

3. Vlerësimi i riskut kryhet mbi bazën e të gjithë informacionit në dispozicion, përfshirë:

a) klasifikimin e agentëve biologjikë që përbëjnë, ose mund të përbëjnë, rrezik për shëndetin e njeriut, sipas kritereve të dhënë në nenin 2, pika 2;

b) rekomandimet nga autoriteti i inspektimit përgjegjës për shëndetin në punë për kontrollin e agentit biologjik, në mënyrë që të mbrohet shëndeti i punëmarrësve kur janë ose mund të jenë të ekspozuar ndaj këtij agjenti si rezultat i punës së tyre;

c) informacionin mbi sëmundjet që mund të ngjiten si rezultat i punës së punëmarrësve;

ç) efektet potenciale alergjene ose toksikogjene, si rezultat i punës së punëmarrësve;

d) njohuritë për një sëmundje, nga e cila konstatohet se vuan një punëmarrës dhe që ka lidhje të drejtpërdrejtë me punën e tij.

4. Agentët biologjikë, të klasifikuar në grupet 2 deri në 4 sipas pikës 2 të nenit 2 jepen në shtojcën III. Nëse agjenti biologjik për t'u vlerësuar nuk mund

të klasifikohet qartazi në një prej grupeve, ai duhet të klasifikohet në grupin më të lartë të riskut ndërmjet alternativave.

Neni 4

Zbatimi i neneve të ndryshme lidhur me vlerësimin e risqeve

1. Nëse rezultatet e vlerësimit të riskut tregojnë se ekspozimi dhe/ose ekspozimi potencial ndaj një agjenti biologjik të grupit 1 është pa risk të identifikueshme për shëndetin e punëmarrësve, nenet 5 deri në 17 nuk zbatohen. Megjithatë, për punën me agentët biologjikë të grupit 1, përfshirë vaksinat e gjalla të dobësuara, parimet e sigurisë dhe higjienës në punë duhet të zbatohen në çdo rast.

2. Kur veprimtaria nuk ka një qëllim të vullnetshëm për të punuar ose përdorur një agjent biologjik, por vlerësimi i riskut tregon ekspozimin e punëmarrësve ndaj një agjenti biologjik, ashtu si edhe për veprimtaritë për të cilat ka një listë indikative në shtojcën I, zbatohen nenet 5, 7, 8, 10, 11, 12, 13 dhe 14 të kësaj rregulloreje. Këto nene nuk zbatohen në rastet kur rezultatet e vlerësimit të riskut tregojnë se ato janë të panevojshme.

SEKSIONI II

DETYRIMET E PUNËDHËNËSVE

Neni 5

Zëvendësimi

Punëdhënësi shmang përdorimin e një agjenti biologjik të dëmshëm, kur natyra e veprimtarisë e lejon një gjë të tillë, duke e zëvendësuar atë sipas rastit, bazuar në njohuritë aktuale, me një agjent biologjik, i cili, në kushtet e përdorimit të tij, nuk është i rrezikshëm ose është më pak i rrezikshëm për shëndetin e punëmarrësve.

Neni 6

Reduktimi i risqeve

1. Kur rezultatet e vlerësimit të riskut sipas nenit 3 të kësaj rregulloreje tregojnë risk për sigurinë ose shëndetin e punëmarrësve, ekspozimi i tyre duhet të parandalohet.

2. Kur parandalimi i ekspozimit sipas pikës 1 të këtij neni nuk është teknikisht i mundur, duke pasur parasysh natyrën e veprimtarisë dhe vlerësimin e riskut, risku i ekspozimit duhet të reduktohet në një nivel aq të ulët, sa është e nevojshme për të mbrojtur në mënyrë të duhur dhe të vazhdueshme sigurinë dhe



shëndetin e punëmarrësve të ekspozuar. Ky reduktim arrihet veçanërisht nëpërmjet masave të mëposhtme, që duhen zbatuar nën dritën e rezultateve të vlerësimit të riskut:

a) kufizimit sa më shumë që të jetë e mundur, të numrit të punëmarrësve të ekspozuar ose që mund të ekspozohen;

b) projektimit të proceseve të punës dhe masave të kontrollit teknik, për të shmangur ose minimizuar çlirimin e agjentëve biologjikë në vendin e punës;

c) masave mbrojtëse kolektive dhe/ose masave të mbrojtjes individuale, kur ekspozimi nuk mund të shmanget nëpërmjet mjeteve të tjera;

ç) masave higjieno-sanitare për parandalimin ose reduktimin e transferimit ose çlirimit aksidental të një agjenti biologjik nga vendi i punës;

d) përdorimit të shenjës së rrezikut biologjik, të paraqitur në shtojcën II dhe shenjave të tjera të rëndësishme paralajmëruese;

dh) hartimit të planeve për të përballuar aksidente që përfshijnë agjentë biologjikë;

e) testimit, kur është e nevojshme dhe teknikisht e mundur, mbi praninë jashtë kufizimit fizik parësor² të agjentëve biologjikë të përdorur në punë;

ë) mjeteve që mundësojnë, pas trajtimit të duhur kur është e përshtatshme, grumbullimin, ruajtjen dhe asgjësimin në mënyrë të sigurt të mbetjeve nga ana e punëmarrësve, përfshirë përdorimin e kontejnerëve të sigurt dhe të identifikueshëm;

f) masa për manipulimin dhe transportimin e sigurt të agjentëve biologjikë brenda vendit të punës.

Neni 7

Informacion për autoritetet e inspektimit

1. Kur rezultatet e vlerësimit të riskut tregojnë risk për sigurinë ose shëndetin e punëmarrësve, punëdhënësi, kur i kërkohet, vë në dispozicion të autoritetit të inspektimit informacione të përshtatshme lidhur me:

a) rezultatet e vlerësimit të riskut;

b) veprimtaritë, në të cilat punëmarrësit kanë qenë

² “Kufizimi fizik parësor” është kontejneri i parë dhe/ose mjedisi i punës ku ka kontakt të drejtpërdrejtë me agjentë biologjikë, që sigurojnë mbrojtjen e punëmarrësve dhe të mjedisit jashtë tij. Kufizimi fizik parësor kërkon përdorimin e kontejnerëve të përshtatshëm, zbatimin e praktikave të mira mikrobiologjike si dhe përdorimin e pajisjeve të përshtatshme të sigurisë, si kabinetet e sigurisë biologjike etj.

të ekspozuar ose mund të kenë qenë të ekspozuar ndaj agjentëve biologjikë;

c) numrin e punëmarrësve të ekspozuar;

ç) emrin dhe aftësitë profesionale të personit përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë;

d) masat mbrojtëse dhe parandaluese të marra, përfshirë procedurat dhe metodat e punës;

dh) planin e emergjencës për mbrojtjen e punëmarrësve nga ekspozimi ndaj një agjenti biologjik të grupit 3 ose 4, si rezultat i humbjes së kontrollit fizik mbi këtë agjent.

2. Për çdo aksident ose incident që mund të çojë në çlirimin e një agjenti biologjik dhe që mund të shkaktojë infeksione dhe/ose sëmundje të rënda të njerëzit, punëdhënësi informon menjëherë autoritetet kompetente sipas legjislacionit në fuqi mbi aksidentet në punë.

3. Kur ndërmarrja pushon veprimtarinë, lista e punëmarrësve të ekspozuar, siç parashikohet në nenin 11 të kësaj rregulloreje dhe kartelat e shëndetit në punë siç parashikohet në nenin 14, dorëzohen pranë strukturave rajonale të shëndetit publik, në përputhje me legjislacionin dhe/ose praktikën kombëtare në fuqi.

Neni 8

Higjiena dhe mbrojtja individuale

1. Për të gjitha veprimtaritë ku ka një risk për sigurinë ose shëndetin e punëmarrësve për shkak të punës me agjentë biologjikë, punëdhënësit marrin masa të përshtatshme për të siguruar që:

a) punëmarrësit të mos konsumojnë ushqime, lëngje ose duhan në zonat e punës ku ka një risk për ndotje nga agjentët biologjikë;

b) punëmarrësit të pajisen me veshje mbrojtëse ose veshje të tjera speciale të përshtatshme;

c) punëmarrësve t'u vihen në dispozicion mjete dhe mjedise të përshtatshme dhe të mjaftueshme për shërbimet higjieno-sanitare, që mund të përfshijnë larës për sytë dhe/ose antiseptikë për lëkurën;

ç) çdo pajisje mbrojtëse e nevojshme:

- të ruhet siç duhet në një vend të mirëpërcaktuar,

- të kontrollohet dhe pastrohet pas çdo përdorimi dhe, kur është e mundur, edhe përpara përdorimit të saj,

- kur është me defekt, të riparohet ose të zëvendësohet përpara përdorimit të mëtejshëm;

d) të ketë të dokumentuara procedura për marrjen, manipulimin dhe përpunimin e mostrave me origjinë njerëzore ose shtazore.



2. Kur largohet nga zona e punës, punëmarrësi duhet të heqë veshjet e punës dhe pajisjet mbrojtëse, përfshirë veshjet mbrojtëse të përmendura në pikën 1 të këtij neni, që janë ndotur nga agjentët biologjikë. Përpara marrjes së masave të përmendura në pikën 2 të këtij neni, këto veshje të mbahen veçmas nga veshjet e tjera.

Punëdhënësi duhet të sigurojë që këto veshje dhe pajisje mbrojtëse të dezinfektohen dhe pastrohen, ose, nëse është e nevojshme, të shkatërrohen.

3. Kostot financiare të masave të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk u ngarkohen punëmarrësve.

Neni 9

Informimi dhe formimi i punëmarrësve

1. Punëdhënësi merr masat e duhura për të siguruar formim të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm të punëmarrësve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në ndërmarrje ose në filialet e saj, mbi bazën e të gjithë informacionit të disponueshëm, në veçanti, në formën e informacionit dhe udhëzimeve lidhur me:

- a) risqet potenciale për shëndetin;
- b) masat për të parandaluar ekspozimin;
- c) kërkesat higjieno-sanitare;
- ç) përdorimin e pajisjeve dhe veshjeve mbrojtëse;
- d) masat për parandalimin e incidenteve, si dhe hapat që duhen marrë nga punëmarrësit në rastin e incidenteve.

2. Formimi i punëmarrësve:

- a) kryhet përpara fillimit të punës që përfshin agjentë biologjikë;
- b) përshtatet në mënyrë që të merren parasysh risqet e reja ose ndryshimet e risqeve ekzistuese; dhe
- c) përsëritet në mënyrë periodike dhe në çdo rast që është e nevojshme.

Neni 10

Informimi i punëmarrësve në raste të veçanta

1. Punëdhënësi ofron udhëzime me shkrim në vendin e punës dhe, kur është e nevojshme, vendos tabela që përmbajnë minimalisht procedurën që duhet ndjekur në rastin e:

- a) një aksidenti ose incidenti të rëndë që përfshin manipulimin e një agjenti biologjik;
- b) manipulimit të një agjenti biologjik të grupit 4, sipas pikës 2 të nenit 2 të kësaj rregulloreje.

2. Punëmarrësit i raportojnë menjëherë personit përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë çfarëdolloj aksidenti ose incidenti që përfshin manipulimin e një agjenti biologjik.

3. Punëdhënësi informon menjëherë punëmarrësit dhe/ose përfaqësuesit e punëmarrësve për çdo aksident ose incident që mund të ketë rezultuar në çlirimimin e një agjenti biologjik dhe i cili mund të shkaktojë infeksion dhe/ose sëmundje të rëndë për njerëzit.

Për më tepër, kur ndodh një aksident ose incident i rëndë, punëdhënësi informon sa më shpejt që të jetë e mundur punëmarrësit dhe/ose përfaqësuesit e tyre në ndërmarrje, apo filialet e saj, mbi shkaqet e tyre, si dhe mbi masat e marra, ose që duhen marrë, për të përmirësuar situatën.

4. Çdo punëmarrës ka akses vetëm në informacionin e listës së përmendur në nenin 11 të kësaj rregulloreje, që ka lidhje me të personalisht.

5. Punëmarrësit dhe/ose çdo përfaqësues i tyre në ndërmarrje ose filialet e saj kanë akses në informacionin kolektiv anonim.

6. Punëdhënësi i pajis punëmarrësit dhe/ose përfaqësuesit e tyre, me kërkesë të tyre, me informacionin e parashikuar në pikën 1 të nenit 7 të kësaj rregulloreje.

Neni 11

Lista e punëmarrësve të ekspozuar

1. Punëdhënësi mban një listë të punëmarrësve të ekspozuar ndaj agjentëve biologjikë të grupit 3 dhe/ose 4 të klasifikuar sipas pikës 2 të nenit 2 të kësaj rregulloreje, ku tregohet lloji i punës së kryer dhe, kur është e mundur, agjenti biologjik ndaj të cilit ata janë ekspozuar, si dhe të dhënat e ekspozimeve, aksidenteve dhe incidenteve, sipas rastit.

2. Lista e përmendur në pikën 1 të këtij neni ruhet minimalisht 10 vjet pas përfundimit të ekspozimit ndaj agjentëve biologjikë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe/ose praktikat kombëtare.

Lista ruhet për një kohë më të gjatë, deri në 40 vjet pas ekspozimit të fundit të njohur, në rastin e ekspozimeve që mund të rezultojnë në infeksione, të cilat:

a) shkaktohen nga agjentë biologjikë që njihet se mund të shkaktojnë infeksione të vazhdueshme ose të fshehura;

b) bazuar në njohuritë aktuale, janë të padiagnostikuesueshme, derisa sëmundja zhvillohet shumë vite më vonë;

c) kanë periudha inkubacioni veçanërisht të gjata përpara se sëmundja të zhvillohet;

ç) rezultojnë në sëmundje që rishfaqen me raste pas një periudhe të gjatë, pavarësisht trajtimit; ose



d) mund të kenë pasoja (*sequelae*) të rënda afatgjata.
3. Mjeku i punës, personi përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe autoritetet e inspektimit, kanë akses te lista e përmendur në pikën 1 të këtij neni.

Neni 12

Konsultimi dhe pjesëmarrja e punëmarrësve

Konsultimi dhe pjesëmarrja e punëmarrësve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në lidhje me çështjet e mbuluara nga kjo rregullore zhvillohen në përputhje me nenin 13 të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”.

Neni 13

Njoftimi i autoritetit kompetent

1. Punëdhënësi njofton paraprakisht autoritetin kompetent për përdorimin për herë të parë të:

- a) agentëve biologjikë të grupit 2;
- b) agentëve biologjikë të grupit 3;
- c) agentëve biologjikë të grupit 4.

Njoftimi kryhet të paktën 60 ditë përpara fillimit të punës.

Punëdhënësi gjithashtu njofton paraprakisht autoritetin kompetent për përdorimin për herë të parë:

- të çdo agjenti biologjik shtesë të grupit 4; dhe
- të çdo agjenti biologjik të ri shtesë të grupit 3, kur vetë punëdhënësi në mënyrë provizore klasifikon atë agjent biologjik.

Autoriteti kompetent nxjerr udhëzim për procedurën e verifikimit të klasifikimit provizor të agentëve biologjikë.

2. Laboratorëve që ofrojnë shërbim diagnostikues në lidhje me agjentët biologjikë të grupit 4 u kërkohet të kryejnë vetëm një njoftim fillestar lidhur me objektin e përdorimit të tyre.

3. Një njoftim i ri duhet të kryhet në çdo rast kur ka ndryshime thelbësore në proceset ose procedurat, me rëndësi për sigurinë ose shëndetin në punë, që e bëjnë të pavlefshëm njoftimin e mëparshëm.

4. Njoftimi i përmendur në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni përmban:

- a) emrin dhe adresën e ndërmarrjes dhe/ose filialeve të saj;
- b) emrin dhe aftësitë profesionale të personit përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë;
- c) rezultatet e vlerësimit të riskut të përmendur në nenin 3 të kësaj rregulloreje;
- ç) llojet (speciet) e agjentit biologjik;

d) masat mbrojtëse dhe parandaluese që janë parashikuar.

SEKSIONI III DISPOZITA TË PËRZIERA

Neni 14

Mbikëqyrja shëndetësore

1. Kur rezultatet e vlerësimit të riskut tregojnë një risk për sigurinë ose shëndetin, punëdhënësi merr masa për kryerjen e mbikëqyrjes shëndetësore të punëmarrësve në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe praktikën përkatëse.

2. Mbikëqyrja shëndetësore e përmendur në pikën 1 të këtij neni kryhet për çdo punëmarrës:

- a) përpara ekspozimit të parë;
- b) në intervale të rregullta në vazhdimësi.

Këto masa janë të tilla që të mund të përfshijnë këshillim mbi zbatimin e masave higjienike individuale dhe të punës.

3. Vlerësimi i riskut duhet të identifikojë ata punëmarrës të cilët kanë nevojë për masa mbrojtëse individuale.

Kur është e nevojshme, punëdhënësi mundëson vaksina të efektshme për ata punëmarrës që nuk janë të vaksinuar për agjentin biologjik, ndaj të cilit ata janë të ekspozuar ose ka të ngjarë të ekspozohen. Punëdhënësi siguron vaksinat duke marrë parasysht kodin e rekomanduar të praktikës të përcaktuar në shtojcën VII.

Kur vërehet se një punëmarrës vuan nga një infektion dhe/ose sëmundje që dyshohet të jetë rezultat i ekspozimit ndaj agentëve biologjikë, mjeku i punës kryen mbikëqyrje shëndetësore edhe për punëmarrësit e tjerë që janë ekspozuar në mënyrë të ngjashme.

Në këtë rast, në përputhje me nenin 3 të kësaj rregulloreje kryhet një rivlerësim i riskut të ekspozimit.

4. Kur kryhet mbikëqyrja shëndetësore, mjeku i punës dokumenton të dhënat shëndetësore individuale, të cilat ruhen minimalisht 10 vjet pas përfundimit të ekspozimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe praktikën kombëtare.

Në rastet e veçanta të përmendura në paragrafin e dytë të pikës 2 të nenit 11 të kësaj rregulloreje, mjeku i punës ruan të dhënat shëndetësore individuale për një kohë më të gjatë, deri në 40 vjet pas ekspozimit të fundit të njohur.

5. Mjeku i punës propozon çdo masë mbrojtëse



ose parandaluese që duhet marrë në lidhje me çdo punëmarrës individual.

6. Punëdhënësi siguron që punëmarrësve t'u jepet informacion dhe këshillim lidhur me çdo mbikëqyrje shëndetësore, të cilës ata mund t'i nënshtrohen pas përfundimit të ekspozimit.

7. Në përputhje me legjislacionin në fuqi:

a) punëmarrësit kanë akses te rezultatet e mbikëqyrjes shëndetësore që kanë të bëjë me ta; dhe

b) punëmarrësit e interesuar ose punëdhënësi mund të kërkojnë një rishikim të rezultateve të mbikëqyrjes shëndetësore.

8. Në shtojcën IV jepen rekomandime praktike për mbikëqyrjen shëndetësore të punëmarrësve.

9. Të gjitha rastet e sëmundjeve ose vdekjeve të identifikuar si rezultat i ekspozimit në punë ndaj agentëve biologjikë deklarohen pranë autoritetit të inspektimit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dokumentet e tjera rregullatore lidhur me mbikëqyrjen shëndetësore.

Neni 15

Shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe veterinar përveç laboratorëve diagnostikues

1. Për qëllimin e vlerësimit të riskut, punëdhënësi i kushton vëmendje të veçantë:

a) pasigurive rreth pranisë së agentëve biologjikë te pacientët njerëz ose kafshë dhe në materialet dhe mostrat e marra prej tyre;

b) rrezikut të paraqitur nga agentët biologjikë të njohur ose të dyshuar si të pranishëm në pacientët njerëz ose kafshë dhe materialet dhe mostrat e marra prej tyre;

c) risqeve të paraqitura për shkak të natyrës së punës.

2. Punëdhënësit në shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe veterinar marrin masa të përshtatshme për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve të ekspozuar ose që mund të ekspozohen.

Këto masa përfshijnë në veçanti:

a) specifikimin e procedurave të përshtatshme të dekontaminimit dhe dezinfektimit; dhe

b) zbatimin e procedurave që mundësojnë manipulimin dhe asgjësimin pa ndonjë risk të mbetjeve të kontaminuara.

3. Në mjediset e izolimit (karantinës) ku mbahen pacientë njerëz ose kafshë, të cilët janë ose dyshohet se janë të infektuar me agentë biologjikë të grupit 3

ose 4, në mënyrë që risku i infektimit të minimizohet, përzgjidhen masa për kontrollin sipas kolonës A të shtojcës V të kësaj rregulloreje.

Neni 16

Masa të veçanta për laboratorët, dhomat e kafshëve dhe proceset industriale

1. Në laboratorët që punojnë me agjentë biologjikë, përfshirë laboratorët diagnostikues dhe në dhomat për kafshët laboratorike të cilat janë infektuar në mënyrë të vullnetshme me agjentë biologjikë të grupit 2, 3 ose 4 ose të cilat janë ose dyshohet se janë mbartës të këtyre agentëve duhet të veprohet si më poshtë:

a) Laboratorët që zhvillojnë aktivitete me agjentë biologjikë të grupit 2, 3 ose 4 për kërkime, zhvillim, mësimdhënie ose qëllime diagnostikuesuese përcaktojnë masat e kontrollit në përputhje me shtojcën V, në mënyrë që risku i infektimit të minimizohet;

b) Pas vlerësimit të riskut, në përputhje me shkallën e riskut dhe pas përcaktimit të nivelit të kontrollit fizik të nevojshëm për agentët biologjikë, përcaktohen masa në përputhje me shtojcën V. Veprimtaritë që duhet të kryhen për trajtimin e agentëve biologjikë zbatohen:

i) vetëm në zonat e punës që i korrespondojnë të paktën nivelit 2 të kontrollit, për agjentë biologjikë të grupit 2;

ii) vetëm në zonat e punës që i korrespondojnë të paktën nivelit 3 të kontrollit, për agjentë biologjikë të grupit 3;

iii) vetëm në zonat e punës që i korrespondojnë të paktën nivelit 4 të kontrollit, për agjentë biologjikë të grupit 4.

c) Laboratorët që trajtojnë materiale, lidhur me të cilat ekzistojnë pasiguri rreth pranisë së agentëve biologjikë që mund të shkaktojnë sëmundje te njerëzit, por që nuk kanë si synim punën me agjentë biologjikë të tillë si kultivimi, përqendrimi, duhet të zbatojnë të paktën një kontroll të nivelit 2. Nivelet e kontrollit 3 ose 4 duhet të përdoren, kur dihet ose dyshohet se ato janë të nevojshme, përveç rasteve kur udhëzimet e ofruara nga autoriteti kompetent tregojnë se, në disa raste të caktuara, është i përshtatshëm një nivel më i ulët i kontrollit.

2. Për proceset industriale që përdorin agjentë biologjikë të grupit 2, 3 apo 4 duhet të merren masat e mëposhtme:

a) Parimet e kontrollit të përcaktuara në pikën 1 (b, ii) të këtij neni duhet të zbatohen edhe për proceset industriale që përdorin agjentë biologjikë të



grupit 2, 3 ose 4, mbi bazën e masave praktike dhe procedurave të përshtatshme të dhëna në shtojcën VI;

b) Në përputhje me vlerësimin e riskut të lidhur me përdorimin e agjentëve biologjikë të grupit 2, 3 apo 4, autoriteti kompetent mund të vendosë për masa të përshtatshme shtesë, të cilat duhet të zbatohen në përdorimin industrial të këtyre agjentëve biologjikë.

3. Për të gjitha veprimtaritë që janë objekt i pikës 1 ose 2 të këtij neni, kur nuk ka qenë e mundur kryerja e një vlerësimi përfundimtar të një agjenti biologjik, por kur përdorimi i parashikuar i tij mund të përbëjë risk të rëndë për shëndetin e punëmarrësve, veprimtaritë mund të zhvillohen vetëm në vendet e punës me të paktën nivelin 3 të kontrollit.

Neni 17

Përdorimi i të dhënave

Ministria përgjegjëse për shëndetësinë ka akses në të dhënat e mbledhura nga mjekët e punës, sipas pikës 9 të nenit 14. Këto të dhëna mund të përdoren vetëm për qëllime kërkimi, vendimmarrjeje dhe statistikore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ruajtjen e të dhënave personale.

Neni 18

Klasifikimi i agjentëve biologjikë të paklasifikuar

1. Për agjentët biologjikë që nuk përfshihen në listën e shtojcës III, punëdhënësi propozon klasifikim provizor sipas pikës 2 të nenit 2 të kësaj rregulloreje.

2. Nëse agjenti biologjik për t'u vlerësuar nuk mund të klasifikohet qartësisht në një prej grupeve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 2, ai klasifikohet në grupin e riskut më të lartë ndërmjet alternativave.

3. Njoftimi i autoritetit kompetent në rastin e klasifikimit provizor bëhet sipas pikës 1 të nenit 13 të kësaj rregulloreje.

Neni 19

Udhëzuesit praktik

Për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe bazuar në udhëzues ndërkombëtarë, ministria përgjegjëse për shëndetësinë nxjerr një udhëzim për procedurën e verifikimit të klasifikimit provizor të agjentëve biologjikë.

SHTOJCA I

LISTË TREGUESE E VEPRIMTARIVE QË MUND TË PËRFSHIJNË AGJENTË BIOLOGJIKË NË MËNYRË TË PAVULLNETSHME (Neni 4(2))

1. Puna në impiantet e prodhimit të ushqimit.
2. Puna në bujqësi.
3. Veprimtari të punës ku ka kontakt me kafshë dhe/ose produkte me origjinë shtazore.
4. Puna në shërbimet e kujdesit shëndetësor, përfshirë njësitë e izolimit (karantinës) dhe të mjekësisë ligjore.
5. Puna në laboratorë klinike, veterinarë dhe diagnostikues, me përjashtim të laboratorëve diagnostikues mikrobiologjikë.
6. Puna në impiantet për asgjësimin e mbeturinave të ngurta.
7. Puna në instalimet e pastrimit të ujërave të zeza.

SHTOJCA II

SHENJA E RREZIKUT BIOLOGJIK (neni 6(2)(c))



Shenja e rrezikut biologjik

SHTOJCA III

LISTË E AGJENTËVE BIOLOGJIKË TË KLASIFIKUAR NË GRUPET 2, 3 DHE 4³ (neni 2 (2) dhe neni 3 (4))

SHËNIME HYRËSE

1. Në përputhje me fushën e zbatimit të kësaj rregulloreje, vetëm agjentët që njihen se shkaktojnë infeksion dhe/ose sëmundje infektive të njerëzimit janë përfshirë në listën e klasifikuar.

Kur është e përshtatshme, jepen tregues për potencialin toksik dhe/ose alergjik të këtyre agjentëve, sipas pikës 10 të kësaj shtojce. Patogjenët shtazorë dhe bimorë që njihen se nuk ndikojnë të njerëzimit përjashtohen.

³ Sipas direktivës 2000/54/EC "Mbi mbrojtjen e punonjësve nga risqet e lidhura me ekspozimin ndaj agjentëve biologjikë në punë".



Në këtë listë të agentëve biologjikë të klasifikuar, nuk janë marrë parasysh mikroorganizmat e modifikuar gjenetikisht.

2. Lista e agentëve të klasifikuar është bazuar në efektet e këtyre agentëve mbi punëmarrësit e shëndetshëm. Nuk merren në konsideratë efektet e veçanta tek ata persona, ndjeshmëria e të cilëve mund të ndikohet për një arsye ose një tjetër, si sëmundjet e mëparshme, mjekimi me barna, imuniteti i kompromentuar, shtatzënia ose ushqyerja me gjë.

Risku shtesë për këta punonjës duhet të konsiderohet si pjesë e vlerësimit të riskut.

Në disa procese industriale të caktuara, disa lloje të caktuara punësh laboratorike ose disa punë të caktuara me kafshët që përfshijnë ekspozim real ose të mundshëm ndaj agentëve biologjikë të grupit 3 ose 4, çdo masë parandaluese teknike e marrë duhet të jetë në përputhje me nenin 16.

3. Agentët biologjikë, të cilët nuk janë përfshirë në listë si të grupit 2, 3 apo 4, nuk klasifikohen në mënyrë të nënkuptuar në grupin 1.

